

**AKT THEMELIMI I SHOQËRISË
LEGIT SHPK**

SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

**PJESA I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Emri**

- 1.1. Emri i Shoqërisë është: **Legit sh.p.k.** (më poshtë referuar si "Shoqëria").

**Neni 2
Selia e Shoqërisë**

- 2.1. Selia e Shoqërisë do të jetë në adresën: Rr. Thoma Huaja, Nr. 101, L.1, Korçë, Shqipëri.

**Neni 3
Objekti i Veprimtarisë së Shoqërisë**

- 3.1. Objekti kryesor i veprimtarisë së Shoqërisë konsiston në krijimin e platformave digjitale për dhënien e shërbimeve ligjore dhe të mbështetjes së biznesit, me fokus në fushën e teknologjisë dhe inovacionit.
- 3.2. Shoqëria mund të zhvillojë çdo aktivitet i cili lidhet drejtpërdrejtë ose jo drejtpërdrejtë me përmbushjen e aktivitetin kryesor të Shoqërisë edhe pse jo e përcaktuar specifikisht.

**Neni 4
Kohëzgjatja**

- 4.1. Shoqëria krijohet për një afat të pacaktuar.

**Neni 5
Kapitali Shoqërisë**

- 5.1 Kapitali i regjistruar i Shoqërisë është në vlerën Lekë 100 (një qind lekë).
- 5.2. Kapitali i regjistruar i Shoqërisë përbën 1 (një) kuotë, me vlerë nominale prej Lekë 100 (një qind lekë) secila.

**Neni 6
Kontributi**

- 6.1. Kontributi në kapitalin e Shoqërisë u ofrua nga ortakja e vetmje në shumën si më poshtë:
1. Kristiana Filip, qytatare shqiptare, e rritur me zotësi të plotë ligjore për të vepruar, lindur në Selanik, Greqi, 23.03.1994, mbajtëse e Pasaportës nr. BC5669586 dhe me numër



personal J45323083U, ka kontribuar në Kapitalin e Shoqërisë me shumën prej Lekë 100 (një qind lekë)

6.2. Sipas kontributit të mësipërm, pronësia e SHOQËRISË në kuota është si më poshtë:

1. Kristiana Filip, qytatare shqiptare, e rritur me zotësi të plotë ligjore për të vepruar, lindur në Selanik, Greqi, 23.03.1994, mbajtëse e Pasaportës nr. BC5669586 dhe me numër personal J45323083U, zotëron 1 (një) koutë e cila korrespondon me 100% të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë.

Neni 7 Transferimi i Koutave

7.1. Koutat mund të transferohen në palët e treta sipas neneve të Statutit.

Neni 8 Administratorja

8.1. Përmes këtij akti, personi më poshtë emërohet si Administratore e Shoqërisë për 1 (një) vit me të drejtë riemërimi:

- Gentiana Kapllani, lindur në Vlorë, Shqipëri, më 14.12.1996, mbajtëse e letërnjoftimit ID me nr. 032719589 dhe numër personal J66214084H në cilësinë për të ushtruar të gjitha kompetencat dhe përgjegjësitë në përputhje me legjislacionin Shqiptar.


8.2. Kompetencat e Administratores janë parashikuar në Statutin e Shoqërisë.

Neni 9 Kopje

9.1 Ky Akt Themelimi është përpiluar në 4 (katër) kopje origjinale.

ORTAKËT

Kristiana Filip



Aprovuar me:
Korçë, më 20.02.2022